

# Mbetjet e Ngurta Urbane

## Viti 2020


**Tiranë, më 21 Shtator 2021:** Në vitin 2020 rezulton të jenë menaxhuar rreth 1,04 milionë tonë mbetje urbane, duke shënuar një rënie me rreth 3,5 %, krahasuar me vitin 2019. Sasia vjetore e mbetjeve urbane të menaxhuara për banorë, në shkallë vendi, në vitin 2020 është 369 kg/banor, nga 381 kg/banor që ishte në vitin paraardhës.

**Tab. 1 Mbetje urbane të menaxhuara gjithsej dhe për banor resident**

Vitet	Tonë	Menaxhuar Gjithsej Kg/Ban/Vit	Mbetje jo urbane Kg/Ban/Vit	Mbetje Urbane Kg/Ban/Vit
2016	1.300.373	452	79	373
2017	1.253.913	436	50	386
2018	1.325.071	462	79	383
2019	1.086.692	381	50	331
2020	1.047.852	369	64	305

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

**Fig. 1 Mbetje urbane të menaxhuara për banor sipas burimeve gjeneruese (kg/banor)**



**Për publikim 21/09/2021**

Në vitin 2020, sasia e mbetjeve jo urbane të menaxhuara bashkë me ato urbane është 17,2 % ndaj sasisë gjithsej, nga 13,0 % që ka qenë në 2019, duke shënuar një rritje me 4,2 %.

**Tab. 2 Mbetje të menaxhuara sipas origjinës gjeneruese**

Vitet	Mbetje tipike familjare dhe te ngjashme me to dhe të ngjashme		Mbetje industriale menaxhuar bashke me ato urbane	
	Tonë	%	Tonë	%
2016	1.072.236	83,0	228.137	17,0
2017	1.109.399	88,5	144.514	11,5
2018	1.097.705	82,8	227.366	17,2
2019	945.024	87,0	141.668	13,0
2020	867.522	82,8	180.330	17,2

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT


Niveli i mbulimit të popullatës me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane është 86,9 %, duke shënuar një rënie me 1,0 %, krahasuar me vitin paraardhës.

**Tab. 3 Shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime për menaxhimin e mbetjeve**

Vitet	Popullsia (rezidente)	Banorë rezidentë të shërbyer	Shkalla e mbulimit
	në vite	për mbetjet	me shërbime
	<b>Banorë</b>	<b>Banorë</b>	<b>%</b>
2016	2.876.101	1.975.531	68,7
2017	2.873.457	1.980.524	68,9
2018	2.866.375	1.882.919	65,7
2019	2.854.191	2.508.834	87,9
2020	2.837.849	2.467.186	86,9

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

**Fig. 2 Shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime për menaxhimin e mbetjeve (%)**



Në përbërjen e mbetjeve urbane komponent kryesor janë mbetjet organike. Në vitin 2020, mbetjet organike përbëjnë rreth 58,5 % të sasisë gjithsej të mbetjeve, kundrejt 58,4 % që ky tregues ishte në vitin 2019.

**Tab. 4 Përbërja e mbetjeve urbane të menaxhuara (%)**

Vitet	Mbetje Organike	Druri	Letër, karton	Qelq	Plastikë	Textile	Metale	Mb. të rrezik. jo spitalore	Elek. PC etj	Inerte	Të tjera	Mbetje spitalore
2016	49,5	5,8	7,9	4,2	10,0	2,8	3,4	0,2	0,8	11,9	3,3	0,03
2017	45,9	3,9	9,5	4,8	16,8	3,2	2,7	0,2	1,2	7,4	3,4	0,01
2018	61,2	5,1	7,7	3,8	9,7	2,2	1,5	0,2	1	5,5	0,1	2,45
2019	58,4	2,4	7,6	3,2	9,0	5,6	1,8	0,1	1,4	7,7	1,7	1,10
2020	58,5	4,6	7,2	4,3	8,5	3,7	1,6	0,6	0,1	8,9	2,0	0,08

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Në vitin 2020 u depozituan rreth 80,2 % e sasisë gjithsej të mbetjeve në landfille dhe fusha mbetjesh, duke shënuar një rritje me 2,2 %, krahasuar me të njëjtin indikator një vit më parë.

Në vitin 2020 u ricikluan 18,1 % e sasisë gjithsej të mbetjeve, ndërkohë që në vitin e kaluar ky tregues ishte 18,7 %. Në vitin 2020 janë hedhur jashtë landfillit 0,5 % e sasisë totale të mbetjeve, duke shënuar kështu një rënie të këtij treguesi me 1,8 %, krahasuar me të njëjtin tregues në vitin 2019.

**Tab. 5 Trajtimi i mbetjeve urbane**

Vitet	Djegje për energji		Djegje për eliminim		Riciklime		Depozitime në landfille		Hedhje jashtë landfillit	
	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%
2016	9.001	0,7	40.783	3,1	224.155	17,2	1.010.335	77,7	16.103	1,2
2017	22.864	1,8	19.816	1,6	218.181	17,4	791.572	77,5	21480	1,7
2018	36.558	2,8	25.978	2,0	245.040	18,5	1.012.517	76,4	4.979	0,4
2019	9.732	0,9	1.744	0,2	203.440	18,7	847.208	78,0	24.538	2,3
2020	11.150	1,1	896	0,1	189.871	18,1	840.658	80,2	5.278	0,5

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT


Në vitin 2020, janë gjeneruar gjithsej rreth 1,17 milionë tonë mbetje urbane, ndërkohë në vitin 2019 kjo shifër ishte rreth 1,20 milionë tonë. Mbetjet të pa menaxhuara në raport me sasinë totale të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2020 janë 1,1 % më shumë se në vitin 2019.

**Tab.6 Mbetje urbane të gjeneruara gjithsej dhe shkalla e menaxhimit të tyre**

Vitet	Mbetje të menaxhuara		Mbetje të pa menaxhuara		Mbetje totale të gjeneruara
	Tonë	%	Tonë	%	Ton
2016	1.300.373	59,0	911.563	41,0	2.211.936
2017	1.253.913	69,0	563.352	31,0	1.817.266
2018	1.325.071	77,0	198.185	23,0	1.523.256
2019	1.086.692	90,4	114.898	9,6	1.201.598
2020	1.047.852	89,3	125.877	10,7	1.173.730

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

**Fig. 3 Menaxhimi i mbetjeve referuar sasisë gjithsej të mbetjeve të gjeneruara (%)**



# Metodologjia

Deri në vitin 2018 statistikat mbi “Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri” mbështeteshin në të dhëna të mbledhura në terren nëpërmjet anketës vjetore mbi mbetjet urbane pranë subjekteve që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre. Në vitin 2020, INSTAT për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane referuar vitit 2019, ka aplikuar për herë të parë metodën inovative nëpërmjet pyetësorëve elektronikë “online” pranë gjithë bashkive të vendit.

Mbetjet e ngurta urbane depozitohen në kazanët e grumbullimit të mbetjeve dhe në vendin tonë, ato mblidhen përgjithësisht të pandara sipas llojit dhe në shumë raste në po të njëjtin vend hidhen edhe mbetje industriale që rezultojnë nga prodhime dhe shërbime të subjekteve të vogla biznesi në territorin urban.

## **Në këtë publikim jepen statistika vjetore për mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri për:**

- Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total dhe referuar banorëve rezidentë sipas viteve.
- Sasia e mbetjeve të menaxhuara ndarë sipas burimeve kryesore gjeneruese.
- Shkalla e mbulimit të popullatës rezidente me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane.
- Përbërja relative e mbetjeve të menaxhuara sipas materialeve dominuese përkundrejt totalit.
- Trajtimi i mbetjeve në sasi dhe përqindje sipas mënyrave kryesore të trajtimit.
- Mbetjet totale të gjeneruara në shkallë vendi dhe mbetjet e pa menaxhuara me fonde publike.

Mbetje të ngurta urbane, sipas përcaktimeve në legjislacionin Evropian, konsiderohen çdo substancë e ngurtë ose objekt që zotëruesi i tyre është i interesuar t'i braktisë dhe dëshiron ose është i detyruar t'i hedhë ato. Zotëruesi, këto materiale fizike, i largon nga vetja e tij duke humbur kështu çdo interes konkret për për këto substanca apo objekte, pavarësisht vlerave që mund të bartin ato në momentin e braktisjes.

Informacioni mbi mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri është vjetor dhe i përgjithësuar në shkallë vendi. Të dhënat e paraqitura në këtë publikim janë mbledhur në terren nëpërmjet intervistimit online me pyetësor elektronik të personelit që merret me menaxhimin e mbetjeve në bashkitë përkatëse.

Mbetjet e ngurta urbane, objekt i këtij publikimi, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat vijnë nga shërbimet komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara, qoftë dhe

përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi për prodhimin e treguesve statistikorë standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar dhe atë evropian, duke implementuar të njëjtat klasifikime dhe përkufizime sipas rregulloreve përkatëse.

Statistikat mbi mbetjet urbane janë subjekt revizionimi dhe përmirësimi, me të dhëna dhe fakte të reja nëse ato regjistrohen pas këtij publikimi. Për më shumë referohuni në linkun: <http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/>

### **Prodhimi dhe publikimi i statistikave mbi mbetjet e ngurta urbane bazohet në:**

#### **Legjislacioni Shqiptar:**

- Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.

#### **Programin të Statistikave Zyrtare të Shqipërisë:**

- Programin e Statistikave Zyrtare të Shqipërisë në periudhën 2017 - 2021.

#### **Legjislacionin e BE-së**

- Rregullorja Nr 2150/2002 mbi “Statistikat e mbetjeve”.
- Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. b2008/98/EC për “Mbetjet dhe raportimin e detyrueshëm të statistikave për mbetjet”.
- Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në statistikat e mbetjeve.
- Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 783/2005, Shtojca II për rregulloren e mbetjeve.
- Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. 2150/2002 për “Kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikat e mbetjeve”.
- Rregullorja e Komisionit Evropian 849/2010 për “Menaxhimin e mbetjeve urbane”.
- Manuali i Statistikave për Mbetjet 2013 i amenduar, Publikim i Eurostat, viti 2013.

### **Informacion**

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikat evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2019, realizuar nga INSTAT.
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante).

### **Informacion mbi vrojtimin**

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### **Në Shërbime**

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

**Mbledhja e informacionit** - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatoohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

**Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjeve neto* - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i Shitjeve neto* - Objektiv i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime.

*Numri i të punësuarve* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

*Indeksi i Numrit të punësuarve* - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Përshtatja sezonale** në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecificimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori II 2021. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit , komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.